



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

NR. 90 DATË 07.10.2008

“Për disa rekomandime për liberalizimin dhe rritjen e konkurrencës në sektorin e energjisë elektrike”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Lindita	MILO(LATI)	Kryetar
Lush	PERPALI	Zv/Kryetar
Servete	GRUDA	Anëtare
Koço	BROKA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.10.2008, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Rekomandime ndaj institucioneve publike mbi liberalizimin e sektorit të energjisë elektrike.

Baze ligjore:

- Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, germa f dhe neni 70, si dhe nenit 5, pika 1 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të grupit të punës së hetimit të përgjithshëm në sektorin e energjisë, pjesa për energjinë elektrike, të paraqitur nga Sekretariati dhe
- Organizimit të seancës konsultative me institucionet e interesuara, Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Entin Rregullator të Energjisë Elektrike, KESH, Operatorin e Sistemit të Trasmetimit;

VËREN SE:

I. Fusha e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

1. Ligji Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (këtu e si vijon Ligji) zbatohet për ndërmarrjet dhe grupimet e ndërmarrjeve, të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, ndikojnë ose mund të ndikojnë në treg.

2. Korporata elektro-energjitike Shqiptare, Operatori i Sistemit të Trasmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe operatorët e tjerë të tregut të energjisë zhvillojnë aktivitetin e tyre si ndërmarrje tregtare dhe si rrjedhim, veprimtaria e tyre është edhe objekt i këtij ligji.

3. Bashkëpunimi me institucionet dhe aktorët e tregut:

- Autoriteti i Konkurrencës në mbështetje të nenit 70 të Ligjit dhe Memorandumit të Mirëkuptimit ka bashkëpunuar ngushtë me Entin Rregullator të Energjisë Elektrike për ndërmarrjen e masave për liberalizimin e tregut të energjisë, për ta bërë tregun më funksional dhe krijimit të mundësisë për zgjedhje nga ana e konsumatorit.
- Autoriteti i Konkurrencës ka bashkëpunuar me Ministrinë që mbulon Energjetikën në funksion të evidentimit të efekteve të reformës legislative dhe efektet e saj në krijimin e një tregu real të energjisë elektrike në kuadër të angazhimeve të Sekretariatit për Energjinë.

II. Qëllimi

4. Qëllimi i hetimit të përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës në tregun e energjisë është evidentimi i nivelit të konkurrencës në treg, duke synuar rritjen e efikasitetit të tregut për të krijuar më shumë përfitime dhe mundësi zgjedhjeje për konsumatorët.

III. Procedurat e ndjekura gjatë hetimit të përgjithshëm

5. Procedurat e ndjekura gjatë hetimit janë bazuar në kreun III të Ligjit Nr. 9121, datë 8.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”. Komisioni i Konkurrencës, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm, në bazë të nenit 24, germa d) dhe nenit 41 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me vendimin Nr. 60 datë 12.11.2007, vendosi hapjen e hetimit të përgjithshëm në tregun e energjisë dhe nën tregjet e tij: karburantet, gazit të lëngshëm dhe energjisë elektrike, për të vërtetuar nëse konkurrenca në këtë treg kufizohet apo shtrembërohet.

6. Raporti i hetimit të përgjithshëm të sektorit të energjisë është ndarë në dy pjesë, energjia elektrike dhe hidrokarburet, për shkak të specifikave të funksionimit dhe shkallës së liberalizimit të secilit prej tregjeve.

7. Raporti “Për hetimin e përgjithshëm në sektorin e energjisë” për pjesën e parë: energjia elektrike, i hartuar nga grupi i punës, iu dërgua për mendim institucioneve si METE dhe ERE ashtu dhe operatorëve të tregut, KESH-Gen, OST, OSSH dhe Shoqatës së Prodhuesve të Pavarur të Energjisë Elektrike.

8. Me datë 15 Shtator 2008 u ftuan në seancë konsultative të gjithë aktorët e përmendur në pikën 7, seancë e cila u zhvillua me pjesëmarrjen e METE, ERE, KESH-Gen dhe OST. Opinioneve të pjesëmarrësve në këtë seancë u reflektuan në raportin përfundimtar “Për hetimin e përgjithshëm në sektorin e energjisë” për pjesën e parë: energjia elektrike.

9. Autoriteti i Konkurrencës ka vërejtur mos-angazhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes si gjatë procesit të hetimit të përgjithshëm ashtu dhe gjatë fazës konsultative.

V. Kuadri ligjor i sektorit të energjisë elektrike

10. Veprimtaria e funksionimit dhe kontrollit të energjisë në Republikën e Shqipërisë është e rregulluar me Ligjin Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Ky ligj përcakton kushtet për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve, në përputhje me parametrat standarde, përmes funksionimit të efektshëm të tregut të energjisë dhe zhvillimit të konkurrencës në këtë sektor, duke pasur parasysh ruajtjen e interesave të konsumatorit dhe respektimin e mjedisit.

11. Gjithashtu, pjesë e kuadrit ligjor në këtë sektor janë ligji Nr. 9379, datë 28.04.2005 “Për eficientësinë e energjisë”, i cili nxit përdorimin me eficientësi të të gjitha llojeve të energjisë dhe ligji Nr. 8937, datë 12.09.2002 “Për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa”. Ky kuadër ligjor plotësohet me një seri aktesh të tjera nënligjore.

VI. Karakteristika e tregut të energjisë elektrike

12. Furnizimi me energji elektrike është një shërbim i ngjashëm me shumë shërbime të tjera, megjithëse ka disa tipare të veçanta. Kështu kërkesa për energji elektrike ndryshon në varësi të periudhave të ndryshme kohore (në një ditë, një vit, ose një cikël biznesi) si rastësisht ashtu edhe jo rastësisht. Për më tepër, energjia elektrike, deri në këto momente, nuk mund të depozitohet në mënyrë ekonomike, që do të thotë se ajo duhet të prodhohet dhe konsumohet në të njëjtën kohë, prandaj që të ruhet stabiliteti i rrjetit duhet që prodhimi dhe konsumi i energjisë të jenë në balancë gjatë gjithë kohës. Një

tjetër karakteristikë e energjisë elektrike është se ajo mund të prodhohet nga një numër teknologjish, gjë që bën që të ketë shumë struktura kostosh për energjinë (p.sh. prodhim hidro, me qymyr, me gaz, nuklear, energji e rinovueshme, etj). Kjo strukturë e kostos ka implikime të rëndësishme për mekanizmin e formimit të çmimit.

13. Gjatë periudhës së studimit është vërejtur se ky treg është i predominuar nga prona publike (KESH-i). Në vitin 2007, prodhimi nga sektori privat i energjisë elektrike përbën vetëm 1.03% të prodhimit të energjisë elektrike. Ky sektor përfaqësohej nga 14 kompani për prodhimin e energjisë elektrike.

VII. Vlerësimi i shkallës së liberalizimit të sektorit të energjisë elektrike dhe problemet e konkurrencës

14. Tregu i energjisë elektrike në Shqipëri është në fazat e procesit të liberalizimit. Por, realizimi i këtij procesi kërkon investime të konsiderueshme kryesisht në burimet e reja energjetike, sistemin e transmetimit dhe atë të shpërndarjes për një efikasitet reale të tregut dhe për të siguruar shërbimin e detyrueshëm publik të furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike.

15. Ky është një sektor i rregulluar nga ERE, i cili ka miratuar një kuadër i plotë ligjor, si dhe ka përgjegjësinë e zbatimit të tij. Enti rregullator ka synuar rregullimin e tarifave që zbatohen për grup-konsumatorët në mënyrë që këto tarifa të reflektojnë kostot reale të energjisë elektrike. Gjithashtu, është synuar liberalizimi i liçensimit të gjenerimit me qëllim që të tërhiqen sa më shumë investitorë privatë për investimin e tij.

16. Sektori i energjisë elektrike në vend është në një situatë të vështirë për shkak të mungesës së burimeve të reja të energjisë dhe linjave të importit, përballë një kërkesë në rritje për konsumin e energjisë.

17. E gjithë reforma e ndërmarrë në këtë sektor sintetizohet në Modelin Shqiptar të Tregut, miratuar me vendimin nr 68, datë 23.06.2008 të Entit Rregullator të Energjisë. Në këtë model përcaktohen të gjithë pjesëmarrësit e tregut dhe marrëdhëniet midis tyre. Synimi kryesor i këtij modeli është futja e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe për klientët e kualifikuar. Në këtë kuadër është synuar liberalizimi i liçensimit të gjenerimit, duke krijuar një numër të mjaftueshëm prodhuesish në treg. OST do të kryejë veprimtaritë e transmetimit dhe operatorit të sistemit. Ndërsa, në shpërndarje dhe furnizimin, do të veprojë OSSH, e cila është në fazat e fundit të procesit të privatizimit. Për të ndihmuar konkurrencën në tregun e shumicës është menduar që në treg të veprojnë një numër tregtarësh.

18. Reforma e deritanishme në këtë sektor ka arritur (të paktën ligjorisht) të bëjë një ndarje të veprimtarive dhe privatizimi i Operatorit të Sistemit Shpërndarjes do të krijonte stimujt e duhur ekonomik në këtë sektor.

Gjithsesi, stadi dhe struktura aktuale e liberalizimit të tregut nuk e bëjnë të mundur zhvillimin e konkurrencës në këtë sektor, kjo është e vërtetë si për tregtinë me shumicë, ashtu edhe për klientët e kualifikuar.

Në tregun e shumicës së energjisë elektrike ekzistojnë në mënyrë të panevojshme dy çmime të shitjes së energjisë elektrike nga prodhues të vegjël dhe të pavarur të energjisë elektrike

Me tarifatat aktuale në treg, kur çmimi i energjisë është nën koston e saj, asnjë ndërmarrje nuk do të kishte stimul të kërkonte statusin e *klientit të kualifikuar*.

Prandaj, në këto kushte, nuk mund të flitet për një hapje të tregut. Përfitimi i statusit të klientit të kualifikuar kërkon përballimin e kostove **buokratike që kërkon përfitimi i statusit sipas akteve nënligjore të ERE**. Të gjitha këto kosto e bëjnë të vështirë aplikimin për statusin e klientit të kualifikuar, prandaj duhet të formulohet një politikë e plotë dhe e qartë, që do të mundësonte që strategjia e zgjedhur, pra nëpërmjet futjes së konkurrencës në tregun e shumicës dhe klientët e kualifikuar, të ketë si rezultat final krijimin e një zgjedhje efektive dhe reale për konsumatorët.

20. Privatizimi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes pritet të rrisë performancën financiare për shkak të rritjes së investimeve të huaja, por sfida reale mbetet krijimi i një oferte dhe kërkesë më elastike nëpërmjet krijimit të ndërmjetësve të tregut dhe rritjen e mundësisë së zgjedhjes për klientët e kualifikuar dhe në një fazë të dytë për klientët tariforë.

21. Furnizuesi me shumicë dhe operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të marrin të gjitha masat për të përmbushur detyrimet e kontratës së shitje-blerjes së energjisë elektrike të lidhur me prodhuesit e vegjël. Aktualisht kontratat e shitje-blerjeve janë një vjeçare (me të drejtë rinovimi) dhe blerësi nuk ka asnjë detyrim për pagesë/kompesimi në rastet kur ai ndërpret lidhjen e këtij centrali me rrjetin. Enti Rregullator i Energjive Elektrike duhet të mbështesë një kontratë afatgjate 15 vjeçare siç edhe kërkohet në ligjin e koncesioneve (Dhjetor 2006 dhe dy VKM përkatëse për dhënie e koncesioneve Janar 2007 dhe Janar 2008) shitje-blerje të energjisë të tipit "take or pay". Kjo do të shmangë barrierën ekzistuese që prodhuesit e vegjël kanë mundësi të prodhojnë, por shpërndarja nuk bën absorbimin e kësaj energjie. Kjo do të krijonte kushte shumë të favorshme për të investuar si nga ana e vetë investitorëve ashtu edhe nga ana e bankave.

22. Në ligjin "Për sektorin e energjisë elektrike" është parashikuar edhe detyrimi për ofrimin e shërbimit publik. Megjithatë, sipas dispozitave të ligjit duket se të gjitha veprimtaritë në këtë sektor janë shërbime publike, duke mos bërë një përcaktim të qartë dhe të detajuar të këtij shërbimi publik dhe të ndërmarrjeve mbi të cilët bie ky detyrim. Specifikimi i këtij detyrimi bëhet i domosdoshëm për të plotësuar detyrimet e ligjit "Për ndihmën shtetërore", pasi vendosja e këtij detyrimi do të kërkonte në shumë raste që shtetit të subvenciononte ndërmarrjen që ka detyrimin për ofrimin e një shërbimi të tillë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa f dhe nenin 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", (i ndryshuar) me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI :

T'i rekomandojë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Entit Rregullator të Energjisë, ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për konsolidimin dhe hapjen reale të tregut të energjisë elektrike në përputhje me direktivat europiane (veçanërisht 2003/54/EC) dhe kërkesat e Sekretariatit për Energjinë për Evropën Juglindore, për të siguruar një treg të energjisë funksional dhe që ofron produktin e mjaftueshëm dhe shërbimin më të mirë në çmimet më të lira të mundshme për konsumatorët.

Në drejtim të liberalizimit të tregut të energjisë elektrike duhen ndërmarrë një sërë veprimesh si:

1. T'i rekomandojë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në rastet kur monopolet natyrore administrohen nga shteti (KESH-Gen dhe OST), duhet të sigurohet që të funksionojnë si ndërmarrje tregtare duke eliminuar mbështetjen financiare (subvencionet) e drejtpërdrejta dhe indirekte nga buxheti i shtetit.

2. T'i rekomandojë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Entit Rregullator të Energjisë Elektrike:

2.1 Përveç Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në treg duhet të funksionojë Operatori i Furnizimit me Shumicë, mundësisht i ndarë nga OSSH, që së bashku me ndërmjetësit e tregut të energjisë dhe krijimin e një Qendre Funksionale Dispeçer do të realizonin një treg funksional të energjisë. Në këtë mënyrë do të hapet dhe/ose të rritet konkurrenca si në krahun e prodhimit ashtu edhe në tregun e furnizimit me shumicë dhe me pakicë me energji.

2.2 Të respektojnë zbatimin e nenit 69 të Ligjit Nr. 9121 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", për të marrë në kohë dhe para miratimit të akteve vlerësimin nga ana e Autoritetit të Konkurrencës për mundësinë e kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës nga aktet ligjore dhe nënligjore, duke rritur transparencën në procesin e privatizimit dhe liberalizimit të mëtejshëm të sektorit të energjisë elektrike

3. Ti rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë Elektrike

3.1 Të rrisë mundësinë e përfshirjes të sa më shumë bizneseve si klientë të kualifikuar, gjë që do ta bënte kërkesën më elastike dhe tregun më të hapur. Liberalizimi i tregut i kryer “*de jure*” duhet të realizohet edhe “*de facto*” për të krijuar mundësinë e më shumë se një zgjedhjeje të burimit të furnizimit, fillimisht për klientët jo tariforë dhe më pas edhe për klientët dhe konsumatorët tariforë. Krijimit të mundësisë së furnizimit nga me shume se nje burim i energjise dhe perdorimi i rrjeteve te trasmetimit dhe shperndarjes, furnizimit me shumice dhe/ose pakicë deri te konsumatori tarifor, sipas pagesave përkatëse të rregulluara nga ERE.

3.2 Që përveç privatizimit të Operatorit të Sistemit Shpërndarjes të ndërmarrë hapat e nevojshëm për liberalizimin e mëtejshëm të tregut nëpërmjet licensimit të ndërmjetësve të tregut. Trasmetimi dhe operimi i sistemit vazhdojnë të mbeten monopole. Ndërsa për sa i përket shërbimeve të prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit në strukturën e konkurrencës në tregun e pakicës vërehet se ato ofrohen nga shumë aktorë tregu. Ndërsa e reja e konkurrencës në tregun e pakicës është futja në strukturë e ndërmjetësve, për të krijuar tregun e shumicës.

3.3 Miratimi i tarifave të tregtimit të energjisë elektrike duhet bërë në mënyrë të balancuar dhe pa diskriminime, të cilat duhet të jenë të orientuara drejt kostos mesatare të ponderuar të ofertës së energjisë, duke marrë në konsideratë si koston mesatare të importit ashtu dhe prodhimit.

3.4 Që të shkrijë dy metodikat e shitje-blerjes së energjisë elektrike mes prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike dhe Furnizuesit Publik me Pakicë(Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes) në një të vetme, duke përcaktuar një metodikë që merr për bazë koston e investimit.

3.5 Të monitorojë Furnizuesit me shumicë dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes që të marrin të gjitha masat për të përmbushur detyrimet e kontratës së shit-blerjes së energjisë elektrike të lidhur me prodhuesit e vegjël

4. T'i rekomandojë OST sh.a. dhe OSSH sh.a. që për çdo rast të sigurojë aksesin në rrjet të të gjithë konsumatorëve në përputhje me rregullat e sjelljes së operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Perpali

(_____)
Zv/Kryetar

Servete Gruda

(_____)
Anëtare

Koço Broka

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E